

Deputetët e Kuvendit të Kosovës me 81 vota për, 28 kundër, 1 abstenim votuan formimin e 14 Komisioneve parlamentare, transmeton Telegrafi.

Adem Grabovci, kryetar i Grupit parlamentare të PDK tha se përkrahin themelimin e 14 komisioneve parlamentare.

Ismet Beqiri nga Lidhja Demokratike e Kosovës po ashtu tha se përkrahin formimin e Komisioneve.

Ndërkaq, Visar Ymeri nga Vetëvendosje tha se do të votojnë kundër Komisioneve, pasi nuk janë të kënaqur me mënyrën e ndarjes së Komisioneve.

Sipas VV-së, numri më i madh i Komisioneve do të duhej t'i takonte opozitës.

Edhe Donike Kada-Bujupi nga AAK u shpreh kundër Komisioneve pasi sipas saj, kjo qeveri po vazhdon me akomodimin e klienteles partiake. Kada-Bujupi ishte kundër mënyrës së ndarjes së Komisioneve.

Ndryshe, kjo ishte hera e dytë që Komisionet parlamentare ishin në votim, pasi herën e kaluara nuk e votuan 2/3 e deputetëve sa kërkohet.